



Key Action 1
– Mobility for learners and staff –

**Hapet thirrja për mobilitete stafi të UPT-së,
në Saxion University of Applied Sciences, Holandë**

Në kuadër të programit Erasmus+ dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, hapet thirrja për aplikime për staf të Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në Saxion University of Applied Sciences.

Lloji i mobilitetit përfshin: Pjesëmarrje në mobilitet një javor, nga data 17 – 21 nëntor 2025, të studentëve dhe stafit, të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës.

Tema e programit të planizuar: *Affordable housing and sustainable construction*

Numri total i stafit: 2

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin:

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Certifikata e gjuhës angleze, (English Language Competency, B2 or higher according to the CEFR)
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës*;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës, për stafin akademik/administrativ;
- Dokumenti Mobility Agreement (Staff Mobility for Teaching/Training)***.

**Plani i mobilitetit dhe periudha e propozuar e mobilitetit duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore ku aplikanti bën pjesë.*

***Kandidatët që do të aplikojnë për të qenë pjesë e mobilitetit si staf akademik ose administrativ në universitetin pritës, paraprakisht duhet të kenë aprovimin nga universitetin pritës (Dekan/Titullar Departamenti ose program studimi/Profesor), për kryerjen e aktivitetit gjatë periudhës së mobilitetit. Ai/ajo do të duhet t'ju dërgojë një dokument paraprak aprovues, të cilin do të duhet ta bashkangjisni me dokumentet e tjera për aplikimin tuaj.*

**** Mobility Agreement for Teaching për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

Afati për aplikim: Deri më 10 nëntor 2025, ora 12.00

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Pas përfundimit të mobilitetit të stafit, personi pjesëmarrës në Saxion University duhet të dorëzojë një raport te departamenti përkatës dhe te Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit, lidhur me aktivitetin.



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Key Action 1
– Mobility for learners and staff –



Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT, mund të kontaktoni në e-mail:
abeqo@upt.al , rkodra@upt.al